



REPUBLICA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar / Premijena / Prodato / Received / Delivered	27-01-2021	1	viti / god / year
Organ / Njësia / Organ / Jedinica / Org / Unit	Nr Prot / Bi Prot / Prot No	Shtojca / Pislog / Appendix	Sasia / Kolicina / Quantity
SKPMSHCK	325/2021		116



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.420/2020

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Eshref Shabani-anëtarë, si dhe Sabile Avdyli, Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.420/2020, të datës 15.12.2020, e parashtruar nga me adresë banimi Lagjja Arbëria Rr “Ahmet Krasniqi”, Nr. 208, Prishtinë, kundër organit të punësimit Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 27.01.2021, mori këtë

V E N D I M

I. APROVOHET si e bazuar ankesa A.nr.420/2020 e datës 15.12.2020, e parashtruar nga ankuesja,

II. ANULOHET Vendimi me numër V.Nr.KD/03/2020 i datës 24.11.2020 i Komisionit Disiplinor të Aviacionit Civil të Kosovës për “Ndalim i pagës në shumën prej 20% për një periudhë prej dy(2)muajve”për ankuesen

III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë kompensimin e mjeteve prej 20% të ndaluara për dy (2) muaj.

IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Kolegjit.

A r s y e t i m

Ankuesja sipas akt emërimit të datës 08.06.2018, në pozitën “Drejtoreshë e Departamentit për Administratë dhe Burime Njerëzore”, në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës, me datën 07.10.2020 i është iniciuar procedurë disiplinore me kërkesën e Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës. Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës me Vendimin me numër V.Nr.KD/03/2020 i datës 24.11.2020,

ankueses i shqipton masën disiplinore "Ndalim i pagës në shumën prej 20% për një periudhë prej dy(2) muajve".

E pakënaqur me vendimin e Komisionit Disiplinor të AACK-se, me datën 15.12.2020 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 3149/2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 21.12.2020 ka përcjellë kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek organi i punësimit. Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me datën 29.12.2020 ka përcjellë përgjigjen në ankesë me numër protokollit 3328/2020 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/65.

Administrimi i provave-Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr.420/2020, të datës 15.12.2020, me numër protokollit 3149/2020, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i Komisionit Disiplinor V.Nr.KD/03/2020 i datës 24.11.2020 me numër protokollit 315 i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; E-mail zyrtar i datës 07.10.2020; E-mail zyrtar i datës 05.10.2020; E-mail zyrtar i datës 09.10.2020; Vendimi i datës 04.11.2020 me Nr.ref.60/2020 i Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës; Vendim i datës 18.05.2020 me Nr.ref.30/2020 për anulimin e Rregullores së brendshme të AAC-së e datës 09.07.2019; E-mail zyrtar i datës 27.11.2020; E-mail zyrtar i datës 20.11.2020; E-mail zyrtar i datës 19.11.2020; E-mail zyrtar i datës 10.11.2020; E-mail zyrtar i datës 09.11.2020; E-mail zyrtar i datës 06.11.2020; E-mail i datës 02.11.2020; E-mail zyrtar i datës 30.10.2020; E-mail zyrtar i datës 29.10.2020; E-mail zyrtar i datës 07.10.2020; Procesverbal i seancës dëgjimore të Komisionit Disiplinor mbajtur me datën 10.11.2020 me znj. për iniciimin e kërkesës të pranuar me datë 07.10.2020 nga Drejtori i Përgjithshëm; E-mail-zyrtar i datës 06.07.2020; E-mail zyrtar i datës 03.07.2020; E-mail -zyrtar i datës 01.07.2020; E-mail- zyrtar i datës 08.06.2020; E-mail zyrtar i datës 04.06.2020; E-mail -zyrtar i datës 02.06.2020; Vendimi i datës 07.04.2020 me numër protokollit 105; E-mail -zyrtar i datës 30.04.2020; E-mail -zyrtar i datës i datës 07.04.2020; E-mail zyrtar i datës 18.02.2020; kërkesë për ndërprerje të pushimit pa pagesë e datës 10.02.2020; Vendimi i datës 30.07.2018; kërkesë për pushim i datës 01.09.2020; Vendim i datës 16.04.2020; E-mail zyrtar i datës 06.04.2020; Buxheti paga 2020; Ankesë ndaj vendimit KD-AAC,nr.2020/KD/315, dt.24.11.2020; Akt emërimi i ankueses i datës 08.06.2020; Përshkrimi i detrvave të punës i datës 15.03.2015; Procesverbal i datës 02.11.2020 me në cilësinë e dëshmitares; Procesverbal i datës 02.11.2020 me znj. për iniciimin e kërkesës të pranuar me datë 07.10.2020 nga Drejtori i Përgjithshëm; Procesverbal i datës 02.11.2020 me z në cilësinë e dëshmitarit; Procesverbal i datës 09.11.2020; Procesverbal i datës 20.10.2020; Procesverbal i datës 24.11.2020; Vendimi i datës 05.11.2020 me numër protokollit 295; Deklaratë e datës 30.10.2020; Vendimi i datës 04.11.2020; E-mail zyrtar i datës 05.11.2020; E-mail zyrtar i datës 05.11.2020; E-mail zyrtar i datës 08.10.2020; Vërejtje e datës 22.07.2020 kundër Menaxheres së Personelit në AAC; Vërejtje e datës 10.08.2020; Vërejtje e datës 21.09.2020; Procesverbal i datës 25.11.2020; Vendimi V.Nr.KD/04/2020 i datës 24.11.2020 me numër protokollit 316 i Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil dhe Përgjigje në ankesë nga organi i punësimit i datës 29.12.2020 bashkë me shkresat e lëndës faqe 1/65.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, konstatoi se ankesa e ankueses **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në shkresat e lëndës, ka konstatuar se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 07.10.2020 përmes e-mailit zyrtar ka iniciuar procedurë disiplinore ndaj ankueses për shkelje të rëndë disiplinore, gjegjësisht shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në shërbimin civil.

Komisioni Disiplinor i themeluar nga Drejtori i Përgjithshëm, me Vendim Nr.Ref.49/2020 të datës 04.09.2020, në përbërje nga: kryesues; dhe dhe anëtarë, përmes e-mailit zyrtar të datës 22.10.2020 e kanë ftuar ankuesen në seancë dëgjimore me datë 26.10.2020.

Ankuesja, me datë 29.10.2020, përmes e-mailit zyrtar është ftuar nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor, për seancë më datë 02.11.2020 në ora 10:00, të njëjtën ditë ankuesja përmes e-mailit zyrtar ka kërkuar që seanca e Komisionit Disiplinor të shtyhet në afat prej pesë(5) ditësh, po ashtu ka kërkuar që t'i ofrohen provat lidhur me shkeljet e supozuara, si dhe e ka kërkuar që të largohet nga Komisioni Disiplinor me pretendimin se ka konflikt të interesit, për shkak se e njëjta është vartëse e znj.

Komisioni Disiplinor, me datë 04.11.2020, ka pranuar nga Drejtori i Përgjithshëm Vendimin me Nr.60/2020 i cili konfirmon se znj. sipas akt emërimit është e autorizuar që të kryej detyrat dhe përgjegjësitë e caktuara për njësinë e personelit me dispozitat e Ligjit 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me datë 24.11.2020, ka nxjerr Vendim me numër V.Nr. KD/03/2020 përmes të cilit nëpunësen civile i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim i pagës në shumën prej 20% për një periudhë prej dy(2)muajve". Parashtruesja e ankesës pretendon se Vendimi me numër V.Nr. KD/03/2020 i datës 24.11.2020 i Komisionit Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është i njëanshëm i paligjshëm sepse iniciimi i procedurës disiplinore është bërë ndaj ankueses dhe ndaj znj. dhe për të dy palët Drejtori i Përgjithshëm i AACK-së ka nxjerrë dy vendime.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, lidhur me pretendimin ankimor të ankueses, fillimisht ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe ka konstatuar se me dispozitat e nenit 49 paragrafi 1 është përcaktuar se në çdo institucion, themelohet një komision disiplinor me mandat 3 vjeçar, që përfshin së paku një përfaqësues të njësisë përgjegjëse, ndërsa me paragrafin 6 të këtij neni është përcaktuar se Qeveria, me propozimin e ministrisë përgjegjëse për administratën publike, me akt nënligjor, miraton rregullat e hollësishme për themelimin, përbërjen, përzgjedhjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor, në përputhje me rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative. Si rrjedhojë, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 21.08.2020 ka aprovuar Rregulloren (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë e cila rregullore në mënyrë të hollësishme specifikon procedurat dhe masat disiplinore për nëpunësit civil, përzgjedhjen e komisionit disiplinor si dhe ankesat e nëpunësve civil me rastin e shqiptimit të masave disiplinore, në pajtim me ligjin Nr.06/L-114 për zyrtarët publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar se me dispozitat e nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, është rregulluar themelimi dhe përbërja e Komisionit Disiplinor, ku përcaktohet se: 2. Komisioni disiplinor përbëhet nga tre (3) anëtarë të cilët duhet të jenë nëpunës civilë, nga të cilët njëri duhet të jetë jurist dhe ka këtë përbërje: 2.1 Nëpunës civil i nivelit drejtues – Kryesues i Komisionit; 2.2.

Nëpunës civil i nivelit profesional – anëtar dhe 2.3. Nëpunës civil i njësisë së burimeve njerëzore – anëtar. Në këtë kuptim, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës me Vendimin Nr.Ref.49/2020 të datës 04.09.2020, ka themeluar Komisionin Disiplinor në përbërje nga: kryesues; dhe , anëtarë, mirëpo nuk ka specifikuar në vendim, titullin e pozitës dhe kualifikimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor, siç kërkohet me dispozitat ligjore përkatëse, andaj Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson se në vendimin mbi themelimin e Komisionit Disiplinor duhet të përshkruhet edhe pozita e punës dhe kualifikimi i anëtarëve, në mënyrë që të konstatohet së në përbërje të komisionit janë tre (3) anëtar me status të nëpunësit civil, ku njeri prej tyre duhet të jetë nëpunës civil i nivelit drejtues dhe një nëpunës civil me kualifikim në fushën e drejtësisë.

Lidhur me pretendimin ankimor për ekzistimin e konfliktit të interesit, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson së Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës ka vepruar në kundërshtim me dispozitat procedurale, për arsye se në bazë të provave që posedojmë në lëndë të paraqitura nga ankuesja kemi tri vërejtje të shqiptuara për nga ankuesja me datën 22.07.2020, 10.08.2020 dhe 21.09.2020 për moskryerjen e punëve dhe detyrave.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e vlerësuar këtë rrethanë, konstaton se meqenëse ankuesja ka pozitën Drejtor i Departamentit të Administratës dhe Burimeve Njerëzore, mbi këtë bazë kjo paraqet direkt konflikt interesi, rrjedhimisht është obligim ligjor që nëse *Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë* duhet të zëvendësohen siç përcaktohet me nenin 10 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përcaktohet se: *“Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë ata zëvendësohen nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Institucionit për raste si në vijim: Kur kryesuesi apo anëtari i komisionit ka qenë i dëmtuar nga shkelësi i dyshuar”*, kështu që Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës ka qenë i obliguar të ndërmarr këtë veprim bazuar edhe në nenin 29 paragrafin 1 nën paragrafin 1.10 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Meqenëse Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës ka autorizuar zyrtaren për Konflikt interesi të vlerësoi rastin dhe të jepet një mendim, zyrtarja ju ka përgjigjur Drejtorit se ka pyetur në Agjencinë Kundër Korrupsion dhe kanë deklaruar se nuk ka konflikt të interesit, mirëpo nuk kemi asnjë shkresë në lëndë që është konstatuar se nuk ka konflikt interesi vetëm gojarisht e vërtetuar.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke e vlerësuar këtë rrethanë, konstaton se meqenëse ankuesja ka qenë në këtë cilësi, atëherë ka qenë e dëmtuar nga ky vendim, mbi këtë bazë kjo paraqet direkt konflikt interesi, rrjedhimisht është obligim ligjor që nëse *Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë* duhet të zëvendësohen siç përcaktohet me nenin 10 paragrafin 5 nën paragrafin 5.2 të Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, përcaktohet se: *“Në rast kur Kryesuesi apo anëtarët e komisionit disiplinor kanë konflikt interesi apo kur konflikti interesit paraqitet ndërkohë ata zëvendësohen nga Udhëheqësi më i Lartë Administrativ i Institucionit për raste si në vijim: Kur kryesuesi apo anëtari i komisionit ka qenë i dëmtuar nga shkelësi i dyshuar”*, kështu që Autoritetit i Aviacionit Civil të Kosovës ka qenë i obliguar të ndërmarr këtë veprim bazuar edhe në nenin 29 paragrafin 1 nën paragrafin 1.10 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankueses kundër Vendimit V.Nr.KD/03/2020 të datës 24.11.2020 të Komisionit Disiplinor të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, që kanë të bëjnë me atë se: "Ndalim i pagës në shumën prej 20% për një periudhë prej dy(2)muajve" është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi sepse nuk është konstatuar drejtë gjendja faktike dhe që rezulton me aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Inicimi i procedurës disiplinore ndaj ankueses është bërë *me arsyetimin se nëpunësja civile znj. ka kryer shkelje disiplinore shkelje të përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil sipas nenit 46 paragrafit 3.6 të Ligjit për Zyrtarët Publikë, ndërsa për zyrtaresh dhe pse ajo ka shkuar në zyrën e znj. dhe janë grindur ajo me Vendimin e Komisionit Disiplinor V.Nr.KD/04/2020 i datës 24.11.2020 me numër protokollit 316 është konstatuar se nuk ka shkelje të procedurës disiplinore sipas rastit të iniciuar me datë 07.09.2020.*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka konstatuar që Komisioni Disiplinor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, me rastin e shqyrtimit të masës disiplinore ndaj ankueses "Ndalim i pagës në shumën prej 20% për një periudhë prej dy(2)muajve", nuk ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike, nuk ka bërë administrimin e saktë të provave që kanë të bëjnë me rastin konkret, duke vepruar kështu në kundërshtim me nenin 46, paragrafi 3, nënparagrafi 3.6 dhe nenin 47 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, sepse kodi i etikës për shërbyesit civilë nuk është në fuqi pasi që me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë sipas nenit 85 shfuqizohet Ligji për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe të gjitha aktet tjera nënligjore për shërbimin civil të Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, është i obliguar që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke shfuqizuar masën e shqyrtuar disiplinore "Ndalim i pagës në shumën prej 20% për një periudhë prej dy(2)muajve.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: "**Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës**", ndërsa me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të këtij ligji është përcaktuar se: "**Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit**".

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë–Departamenti Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda me numër A.nr.420/2020, datë 27.01.2021

Sabile AVDYLI

Sabile Avdyli
Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet

- *Ankueses*
- *Drejtorit të Përgjithshme të Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit në Autoritetin e Aviacionit Civil të Kosovës;*
- *Arkivit të KPMSHCK-së*